

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it, Njësia Bazë e Infermierisë në bashkëpunim me Urdhrin e Infermierit zhvilluan aktivitetin: "Inspirimi drejt profesionit", me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Infermierit.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të fokusonte vëmendjen tek infermierët dhe profesioni i tyre i vështirë, gjithashtu synoi të vlerësonte dhe lartësonte figurën e infermierit dhe rëndësinë që ka ai në ofrimin e shërbimeve shëndetësore të çdo niveli, njëkohësisht, frymëzoi studentët e degës së infermierisë, të cilët po edukohen në universitetin tonë, si dhe nxiti dëshirën e tyre për të mësuar dhe për tu praktikuar që një ditë të meritojnë këtë profesion.

Gjatë aktivitetit u shpërndanë certifikata mirënjohjeje për infermierët në profesion, si dhe certifikata inspiruese për studentët e degës së infermierisë, të cilët janë spikatur gjatë vitit akademik.

Të pranishëm në aktivitet ishin pedagogë, studentë të degës së Infermierisë, Infermieri Mami, ish studentë të cilët punojnë në profesionin e infermierit, si dhe përfaqësues të NJVKSH.

